



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 1183 Prot
02

Datë 20 . 07 2016

AKT PËRPUTHSHMËRIE

PËR DOKUMENTIN “STRATEGJIA TERRITORIALE”

BASHKIA SHKODËR

Në mbështetje të neneve 9, 23 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, të VKM Nr. 671, datë 29.07.2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Kombëtar, të përcaktimeve të Planit të Integruar Ndërsektorial të Bregdetit, të Vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit lidhur me përcaktimin e çështjeve, shpalljen e zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare në planifikim, të Strategjive Sektoriale në fuqi, të normave teknike të planifikimit si dhe të dhënave elektronike bazë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit,

VENDOSI:

1. Lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë për Dokumentin “Strategjia Territoriale”, Bashkia Shkodër.
2. Pjesë përbërëse e këtij Akti Përputhshmërie është:
 - “Raporti i Vlerësimit Teknik” i Dokumentit “Strategjia Territoriale” të Bashkisë Shkodër.
3. Ngarkohet Bashkia Shkodër të reflektojë rekomandimet e “Raportit të Vlerësimit Teknik”, sipas hapave të përcaktuara në raport.

ADELINA GRECA

ADRE.912

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT





REPUBLIKA E SHQIPËRIË

MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

STRATEGJIA TERRITORIALE

BASHKIA SHKODËR

RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK

Koordinator PPK

Znj. Anisa Qorri

Koordinator PINS-Bregdeti

Znj. Albana Koçollari

Koordinator

Znj. Fiona Mali

Koordinator

Znj. Esra Trepçi

Ekspert GIS

Z. Evio Baruti

Eksperte Ligjore

Znj. Rezarta Laçi



20.07.2016


Subjekti i Përputhshmërise	Përputhshmëria¹ <i>LIGJI Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" VKM Nr. 671, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" Plani i Përgjithshëm Kombëtar Plani i Integruar Ndër-Sektorial për Bregdetin</i>
<p>1. Parashikimet e detyrueshme që rrjedhin nga PPK-ja, PKS-ja, PSNQ-ja, në fuqi apo proces hartimi, të cilat ndikojnë në territorin vendor:</p> <p>1.1. Parashikimet e detyrueshme që rrjedhin nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar në proces hartimi;</p> <p>1.2 Parashikimet e detyrueshme që rrjedhin nga Plani i Integruar Ndër-Sektorial për Bregdetin në proces hartimi;</p>	<i>Në përputhje</i>
<p>2. Analiza metabolike dhe vlerësimi i përgjithshëm i territorit të njësisë vendore</p>	<i>Në përputhje</i>
<p>3. Përcaktimi i territorit në bazë të 5 sistemeve: urban, natyror, bujqësor, ujqor dhe infrastrukturor</p>	<i>Në përputhje</i>
<p>4. Identifikimi i problematikave që rrjedhin nga analiza e mësipërme</p>	<i>Në përputhje</i>
<p>5. Vizioni i zhvillimit të territorit të njësisë vendore</p>	<i>Në përputhje</i>

¹ Përputhshmëria e dokumentit *Strategjia Territoriale, Vizioni Strategjik dhe Objektivat e Zhvillimit për Bashkinë Shkodër*, botuar në Regjistrin e Integruar të Territorit nga Bashkia Shkodër, më datë 20.06.2016, e shqyrtuar me kërkesë të Bashkisë Shkodër, me anë të shkresës me lëndë "Kërkesë për shqyrtimin e përputhshmërisë të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër", Nr. 8436 Prot., datë 06.07.2016, protokolluar pranë AKPT me Nr. F183 Prot., datë 11.07.2016.

20.07.2016

<p>6. Objektivat strategjikë për zhvillimin e territorit e njësisë vendore</p>	<p><i>Në përputhje</i></p>
<p>7. Drejtimet për zhvillimin e territorit të njësisë vendore në bazë të treguesve të sistemeve</p>	<p><i>Në përputhje</i></p>
<p>8. Programet dhe projektet kryesore të zhvillimit, të cilat pasqyrojnë përparësitë dhe drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit të njësisë vendore dhe mundësojnë realizimin e objektivave strategjikë</p>	<p><i>Në përputhje</i></p>
<p>9. Plani i veprimeve për realizimin e programeve e të projekteve, përfshirë ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore, burimet njerëzore dhe buxhetin e nevojshëm për realizimin e planit të veprimeve</p>	<p><i>Në përputhje</i></p>
<p>10. Hartat që paraqesin vizionin strategjik të zhvillimit të territorit të njësisë vendore, drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit, objektivat dhe fazat kohore të zbatimit të programeve e projekteve</p>	<p><i>Në përputhje</i></p> <p><i>Në respektim të standardeve të paraqitjes hartografike të dokumenteve të PPV të përcaktuara në Rregulloren e Planifikimit, është e nevojshme që në paraqitjen për miratim, hartat të jenë konform formatit dhe shkallës së duhur.</i></p>
<p>11. Harta e sistemeve ekzistuese së bashku me tabelat dhe treguesit përkatës për secilin sistem</p>	<p><i>Në përputhje</i></p> <p><i>Në respektim të standardeve të paraqitjes hartografike të dokumenteve të PPV të përcaktuara në Rregulloren e Planifikimit, është e nevojshme që në paraqitjen për miratim, hartat të jenë konform formatit dhe shkallës së duhur.</i></p> <p><i>Gjithashtu, sugjerohet që tabelat dhe treguesit përkatës për secilin sistem të bëhen pjesë të hartave, megjithëse janë trajtuar në Raportin e Strategjisë Territoriale.</i></p>

20.07.2016



Bazuar në VKM Nr. 671, dt. 29.07.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", materialet që duhen dorëzuar/botuar në Regjistrin e Integruar të Territorit përpara miratimit të dokumentit të Strategjisë Territoriale, janë:

- I. Nisma e miratuar dhe vendimi i miratimit nga Këshilli Bashkiak;
- II. Dokumentet përbërëse të Strategjisë Territoriale, ku do të përfshihen:
 1. Hartat;
 2. Relacionin shpjegues.
- III. Akti i përputhshmërisë nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.
- IV. Deklarata mjedisore për studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe ndikimit në mjedis, referuar legjislacionit të posaçëm në fuqi.

E RËNDËSISHME

Dokumentet zyrtarë për miratim në Këshill Bashkiak dhe KKT janë:


HARTAT, të cilat duhet të paraqesin të paktën:

1. Përcaktimin e territorit në bazë të 5 sistemeve: urban, natyror, bujqësor, ujor dhe infrastrukturor;
2. Vizionin strategjik të zhvillimit të territorit të njësisë vendore;
3. Drejtimit kryesor të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit;
4. Objektivat dhe fazat kohore të zbatimit të programeve e projekteve.
5. Programet dhe projektet kryesore të zhvillimit.

RELACIONI SHPJEGUES, i cili duhet të përmbajë të paktën:

1. Vizionin e zhvillimit të territorit të njësisë vendore;
2. Objektivat strategjikë për zhvillimin e territorit e njësisë vendore;
3. Drejtimit për zhvillimin e territorit të njësisë vendore në bazë të treguesve të sistemeve;
4. Programet dhe projektet kryesore të zhvillimit, të cilat pasqyrojnë përparësitë dhe drejtimit kryesor të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit të njësisë vendore dhe mundësojnë realizimin e objektivave strategjikë;
5. Planin e veprimeve për realizimin e programeve e të projekteve, përfshirë ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore, burimet njerëzore dhe buxhetin e nevojshëm për realizimin e planit të veprimeve.

20.07.2016



Handwritten signatures and dates at the bottom of the page, including a date of 20.07.2016 and several illegible signatures.